



Namazi me xhemat në xhami – Xhemati i dytë

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد

- Xhemati i dytë në xhami a e merr shpërblimin prej 27-fish?

Thotë Ibn Uthejmini:

لكن كون الجماعة الثانية تنال أجر الجماعة الأولى فهذا ليس بصحيح ، وإلا لكان كل الناس يذهبون إلى المساجد متى شاءوا ، و يصلون جماعة و يقولون :أخذنا أجر سبع و عشرين درجة ، فلا أعلم أحدا قال به أي :أن الصلاة الثانية كصلاة الأولى في الحصول على أجر سبع و عشرين درجة ، فلا أعلم أحدا قال بهذا [لقاء الباب المفتوح " 44 /السؤال رقم 10]

"Që xhemati i dytë të arrijë shpërblimin e xhematit të parë, kjo nuk është e saktë (e vërtetë), sepse përndryshe të gjithë njerëzit do shkonin në xhami kur të donin, dhe do faleshin me xhemat (dmth: do faleshin xhemate-xhemate, një tani, një më vonë, një pak më vonë) dhe do thonin: e morëm shpërblimin njëzet e shtatë shkallë (gradë), por, unë nuk di ndonjë dijetar që e thotë këtë. Dmth: që xhemati i dytë është si xhemati i parë në arritjen e shpërblimit njëzet e shtatë gradë (shkallë). Nuk di asnjë që e thotë këtë." -F-

[Babu Lika El Meftuh, 44/ pyetja numër 10]

Shumë dijetarë e lejojnë xhematin e dytë në xhami, dhe thonë që ka shpërblim për të, por jo sa i pari.

Nje pjesë e dijetarëve bëjnë dallim ndërmjet atyre që:

- Nijeti i tyre është të falen me imamin, por iu ikën xhemati, dhe bëjnë xhemat të dytë.
- Dhe ndërmjet atyre që me qëllim e lënë xhematin e parë, për t'u falur me xhematin e dytë.

Thotë shejh Feuzani:

الذي يعتمد أن يتأخر عن الجماعة و يقول :أصلي جماعة بعدهم ، ما يجوز، هذا تفريق بين المسلمين، هذا حرام (أما من جاء يصلي مع الجماعة و فاتته الصلاة، فلا بأس أن يقيم جماعة ثانية لأنه معذور)

"Personi i cili me qëllim e vonon faljen me xhemat, duke thënë: do falem me xhemat tjetër pas tyre, kjo gjë nuk lejohet. Kjo është përçarje e xhematit të muslimanëve, dhe kjo është haram.

Ama nëse vjen në xhami për t'u falur me xhemat, por nuk e arrin namazin, dhe sheh që janë falur, në këtë rast, nuk ka problem që të bëjë xhemat të dytë, sepse konsiderohet i justifikuar." -F-

Thotë Ibn Uthejmini:

: تعدد الجماعة على قسمين

القسم الأول : أن يكون ذلك راتباً بحيث تتعمد الجماعة الثانية التأخر حتى تقيم جماعة أخرى ، فهذه بدعة ؛ لأن المسجد لا يقام فيه ... إلا جماعة واحدة

[لقاء الباب المفتوح 12 / 41]

"Bërja e disa xhemateve në xhami është dy lloje:

Lloji i parë: xhemat i cili synon vonimin e faljes, me qëllimin që të falen pas xhematit të parë. Kjo është bidat (risi, shpikje në fe), sepse në xhami, nuk falet në të përpos një xhemat..." -F-

[Lika Beeb El Meftuuh 12/41]

Dmth: në xhami falet një xhemat, dhe nuk bën që të synohet me qëllim falja e një xhemati tjetër, pos xhematit të parë. Nëse ndodh që në xhami falet xhemat tjetër, nuk bën të synosh faljen në xhami me xhematin e dytë.

Nëse me qëllim nuk falet me xhematin e parë, për t'u falur me të dytin, ky veprim është i ndaluar, dhe Bidat.

Ama nëse qëllimi është që të falet me xhematin e parë, por kur shkon në xhami, namazi është falur, në këtë rast (sipas këtyre dijetarëve) lejohet të bëjë xhemat të dytë, sepse ai nuk ka pasur qëllim xhematin e dytë, dhe konsiderohet i justifikuar.

Dhe ky xhemat i dytë në këtë rast ka shpërblim (më shumë se me u fal vetëm), por jo sa shpërblimi i xhematit të parë.

Ky është mendimi i një pjese të dijetarëve, por nuk është i saktë.

Më e sakta është se: "Xhemati i dytë në xhami nuk është i pëlqyer."

Shumica e dijetarëve Hanefi, Maliki dhe Shafii e konsiderojnë të qortueshme xhematin e dytë në xhami.

[e përmend këtë shejh Albani ne Rihletun - Nur, kaseta 70]

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka menduar t'ua djegë shtëpitë, atyre që nuk prezantojnë në namazin e Sabahut. Sikur të ishte i ligjëruar xhemati i dytë, Profeti nuk do e mendonte këtë, sepse mundet që ata të vijnë t'a falin sabahun me xhemat të dytë.

Selefët (të parët) tanë nuk bënin xhemat të dytë në xhami.

Shejh Albani përmend fjalën e Imam Shafiut në librin e tij [El Umm] ku thotë:

إذا دخل جماعة المسجد فوجدوا الإمام قد صلى ، صلوا فرادى ، و إن صلوا جماعة جازت صلاتهم ، و إنما أكره ذلك منهم ؛ لأنه لم يكن من عمل السلف

[رحلة النور - شريط 70]

"Nëse nje grup hyjnë në xhami dhe shohin që imami është falur, le të falet secili vetëm.

Nëse falen me xhemat lejohet, por, e konsideroj te papëlqyer këtë, sepse nuk e kanë vepruar Selefët (të parët tanë të mirë)."

[Albani ne Rihletun-Nur - kaseta 70]

Ndërsa sa i përket transmetimit nga Enesi (Radijall-llahu anhu) i cili ka hyrë në xhaminë e بني رفاعه Beni Rifeeah, apo Beni Thea'lebe bashkë me 20 shoqërues të tij, disa thonë se kjo xhami, ka qenë xhami e cila nuk ka pasur Imam dhe as muezin të rregullt.

Personi i cili vjen në xhami me vonesë dhe gjen që namazi është falur është dy lloje:

- Ose është person i cili ka neglizhuar faljen me xhematin e parë.
I tilli sa do të falet me xhemat tjetër, edhe nëse xhemati i dytë është më i madh se xhemati i parë, nuk e arrin atë që i ka humbur prej xhematit të parë.
- Ose është person i cili ka pasur justifikim. I tilli e merr shpërblimin e namazit me xhemat të plotë.

Atij që i ikën xhemati me justifikim i shkruhet shpërblimi i plotë.

Thotë Ibn uthejmini:

المعذور يُكْتَبُ لَهُ أَجْرُ الْجَمَاعَةِ كَامِلًا إِذَا كَانَ مِنْ عَادَتِهِ أَنْ يَصِلِيَ مَعَ الْجَمَاعَةِ، لِقَوْلِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ((إِذَا مَرَضَ الْعَبْدُ أَوْ سَافَرَ كَتَبَ لَهُ مِثْلُ مَا كَانَ يَعْمَلُ صَاحِبًا مَقِيمًا

"Ai që është i justifikuar, i shkruhet shpërblimi i xhematit, i plotë, nëse e ka pasur zakon që të falet me xhemat në xhami. Kjo duke u bazuar në fjalën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem:

((Kur robi sëmuret, apo, udhëton, i shkruhet atij shpërblimi (i asaj pune që nuk e vepron dot kur është sëmure ose në udhëtim) sikur atëherë kur e ka vepruar duke qenë i shëndoshë në vendin e tij))

[Esh- Sherh El Mumti 4/323]

Të njejtën gjë thotë edhe Bin Bazi, dhe argumentohet me këtë hadith, dhe me hadithin:

((إِنَّ فِي الْمَدِينَةِ أَقْوَامًا مَا يَسِرُّمَ سِيرًا وَلَا قَطَعْتُمْ وَاِدِيًّا إِلَّا وَهُمْ مَعَكُمْ، خَبَسَهُمُ الْعَذْوُ))

[البخاري و مسلم]

و فِي لَفْظٍ ((:الَا شَرَكُوكُمْ فِي الْأَجْرِ))

[أحمد و مسلم]

((Në Medinë ka njerëz të cilët janë me ju (dmth: shpërblehen si ju) kudo që keni ecur dhe në çdo luginë që keni kaluar. I kanë penguar arsyet që të bashkangjiten me ju))

Thotë Bin Bazi:

فَدَلْ ذَلِكَ أَنَّ الْمَعْذُورَ حَكَمَهُ الْحَاضِرُ وَ حَكَمَهُ فَاعِلُهُ.

"Ky hadith tregon se personi (i cili nuk prezanton në një adhurim) me arsye, gjykimi i tij është si i atij që ka prezantuar (në atë adhurim), dhe se gjykimi i tij, është sikur i atij që e vepron atë." -F-

Dmth: personi i cili ka arsye dhe justifikim për mos arritjen e bërjes së një pune (adhurimi), ai konsiderohet se e ka bërë atë adhurim dhe shpërblehet për të, sikur ai që e ka vepruar.

Pra, personi i cili e ka zakon që të falet në xhami, por për shkak të një arsye sheriatike nuk arrin dot të falet, i shkruhet shpërblimi sikur e ka falur me xhemat.

Thotë Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem:

مَنْ تَوَضَّأَ فَأَحْسَنَ الْوُضُوءَ ثُمَّ رَاحَ [فِي رَوَايَةٍ: ثُمَّ خَرَجَ عَامِدًا إِلَى الْمَسْجِدِ [فَوَجَدَ النَّاسَ قَدْ صَلَّوْا، أَعْطَاهُ اللَّهُ -عَزَّ وَجَلَّ- مِثْلَ أَجْرِ]) (من صلاها و خضرها ، لا يُنْقَصُ ذَلِكَ مِنْ أَجْرِهِمْ]من أجورهم [شيئا

((Kush merr abdes mirë dhe të plotë, dhe pastaj del me qëllimin për të falur namazin në xhami, dhe (kur mbërrin në xhami) i gjen njerëzit të kenë mbaruar namazin, All-llahu i jep atij shpërblim si shpërblimi i atij që ka prezantuar namazin dhe e ka falur atë -me xhemat-))

[Ebu Dawudi / Albani thotë: Sahih]

Kjo do të thotë se nuk ka arsye të bëjë xhemat të dytë në xhami.

● Lejohet xhemati i dytë, apo edhe i tretë në xhamia të cilat nuk kanë Imam dhe Muezin të rregullt, si për shembull: xhamiat në rrugë udhëtarësh, apo në disa tregje të cilat nuk kanë Imam të rregullt, dhe muezin të rregullt.

Në këto xhamia lejohet xhemati i dytë.

[Siç thotë shejh Albani e të tjerë, dhe për këtë nuk ka mospajtim]

Po ashtu lejohet falja me xhemat në xhami me atë i cili e ka falur atë namaz me xhemat me imamin. Kur dikush i cili nuk e ka arritur namazin me xhemat në xhami, hyn dhe gjen në xhami dikë i cili është falur, lejohet që të bëjë xhemat me këtë i cili është falur.

أن رسول الله صلى الله عليه وسلم رأى رجلاً يصلي وحده ، فقال ((ألا رجل يتصدق على هذا فيصلي معه))

I Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem shikoi një burrë duke u falur vetëm dhe i tha:

((A ka ndonjë burrë t'i jape sadaka këtij, duke u falur me të))

[Ebu Dawudi etj, Albani thotë: Sahih]

Thonë dijetarët: Sadakaja e tij ndaj atij personi është falja me të, ashtu që atij t'i shkruhet namaz me xhemat.

Disa argumentohen me këtë hadith për lejimin e xhematit të dytë.

Por e vërteta është se ky hadith nuk e tregon këtë gjë. Kjo sepse:

- Personi që u fal me të e kishte falur namazin, dhe namazi i tij në këtë rast është namaz vullnetar.
- Personi që u fal me të, e kishte falur namazin me Profetin sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, dhe kishte ç'farë t'i jepte, dhe i dha sadaka atij, me faljen me të. Profeti tha kush i jep sadaka, me faljen me të, gjë e cila nuk është te ai i cili nuk e ka falur namazin. [e përmend këtë shejh Albani]
- Sahabët nuk e kanë kuptuar këtë hadith me kuptimin që lejohet bërja e xhematit të dytë në xhami. Është transmetuar me zinxhir të saktë se Sahabët, kur ka ndodhur që u ka ikur namazi, nuk kanë bërë xhemat të dytë, por janë falur secili në vete.

Thotë Hasan El Basriu (tabi'in i madh):

إن أصحاب رسول الله صلى الله عليه وسلم كانوا إذا فاتتهم الجماعة صلوا في المسجد فرادى .

"Kur shokëve të të Dërguarit të All-llahut iu ikte namazi me xhemat, ata faleshin në xhami secili në vete."

[Albani e konsideron të saktë këtë transmetim]

Imam Shafiu në librin e tij [El Umm] thotë:

"Faljen me xhemat në xhami, pasi është falur namazi (dmth: xhemat i dytë), nuk e kanë vepruar Selefët tanë (të parët tanë të mirë)."

Shumica e dijetarëve Hanefi, Maliki, dhe Shafii e konsiderojnë të qortueshme xhematin e dytë në xhami.

Pra, xhemati i dytë në xhami më e pakta është e qortueshme.

Dhe më e shumta është e ndaluar.

Ndoshta kjo është më e përafërta, dmth: që është e ndaluar.